35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranim përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranim do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Neni 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranim nga Menaxheri i Projektit dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranim dhe të cilat kanë mbetur të porealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranim. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 616-24-7202-5-1-I/C1613

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Neni. Nr.</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe..
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 658,945.96 EUR. në kohëzgjatje prej 210 ditësh.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <p>(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë;</p> <p>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</p> <p>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar.</p> <p>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <p>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar</p> <p>(ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar</p>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 15 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës..
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 180 ditë.
Orari i punës	17.3	<p>Deklaratë për zhvillimin e punimeve në 2 ndërrime.</p> <p>Deklaratë e nënshkruar dhe e vulosur si dhe e noterizuar te noteri ku konfirmohet se punimet do të zhvillohet në 2 ndërrime të punës sipas planit dinamik për projektin në fjalë</p>
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit

		<p>përfundimtar të Kontratës për ditë.</p> <p>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.</p>
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do të përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës me vendim të ZKA
Parapagimi	26.1	<p>Shuma e Parapagimit është:</p> <p>Komuna e Prishtinës do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit në bazë të Ligjit 08/L-193 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2023 Neni 13 pika 4 nga data e caktuar nga Projekti Menaxheri kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim. Shuma e parapagimit është 15 % i vlerës së kontratës.</p> <p>Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.</p> <p>Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.</p>
Mbajtja e Parasë	27.1	<p>Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës së kontratës.</p> <p>Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK.</p> <p>Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".</p>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 5 - 10 vite , varësisht prej garancionit që jep OE-ik. .
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Komerciale -në Prishtinë

Prokurimi: 616-24-7202-5-1-1

Nr i brendshëm:

Titulli: 99 Ndërtimi i ishullit urban Arberi-Pallati i Rinisë

I 99 Ndërtimi i ishullit urban Arberi-Pallati i Rinisë

Kodi i tenderit: EC-2024 PR

Data: 30.09.2024

Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

Nr.	Dokument
1.	1.Marrveshja e grupi & Deklarata nen betim.pdf
2.	2.Qertifikata e Biznesit.pdf
3.	3.Konfirmimi nga banka.pdf
4.	4.Qarkullimi vjetor.pdf
5.	5.Raporti i Auditimit.pdf
6.	6.Lista e Puneve te kryera Arifaj shpk.pdf
7.	7.Lista e Puneve te kryera EURO CONSTRUCTION.pdf
8.	8.Lista e Stafi-KOMPLET-ATK.pdf
9.	9.Stafi i puntoreve profesional.pdf
10.	10.Çertifikatat ISO.pdf
11.	11.Menaxheri i projektit.pdf
12.	12.Udheqesi i punishtes.pdf
13.	13.Inxhinieri i Arkitekuresi.pdf
14.	14.Inxhinieri i Komunikacion.pdf
15.	15.Inxhinieri Hidroteknik.pdf
16.	16.Inxhinieri i Gjeodezis.pdf
17.	17.Inxhinieri i Infrastruktures.pdf
18.	18.Marrveshje per furnizim me Zhavor & Asfalt & Beton.pdf
19.	19.Marrveshja per Paranderje.pdf
20.	20.Deklarat per dy nderrime.pdf
21.	21.Plani Dinamik 120 dite.pdf
22.	22.Afati i implemetimi dhe garancioni.pdf
23.	23.Aneksi 7 Lista e paisjeve.pdf
24.	24.Paisjet nga lista 1-5.rar
25.	25.Paisjet nga lista 6-7.rar
26.	26.Paisjet nga lista 8-14.rar
27.	27.Paisjet nga lista 15-24.rar
28.	28.Paisjet nga lista 25-35.rar
29.	29.Sigurimi i Tenderit.pdf

Përshkrimi i çmimeve

Nr	Emërtimi i grupit	Dokument
1.	99 Ndërtimi i ishullit urban	Paramasa.pdf

Arberi-Pallati i Rinisë

Pjesët e tenderit që do të dorëzohen ndaras:

N/A

AUTORITETI KONTRAKTUES

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, TREPQES NR.2, -, PRISHTINË,

Zyrtari përgjegjës i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 616-24-7202-5-1-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.P. EURO CONSTRUCTION ; EURO ABI SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K.; Arifaj.shpk, Ratkoc, 21050, Ratkoc - Rahovec, Kosovë

E-mail: morina.cons@gmail.com

Personi kontaktues: Defrim Morina

Telefoni: 049-514-500

Faxi: N/A

Numri fiskal:

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

Partneri 1.

Emri i kompanisë: N.N.P. "EURO CONSTRUCTION"

Numri fiskal: 600986866

Vend-Selia: Ratkoc, 21050, Ratkoc - Rahovec, Kosovë

Partneri 2.

Emri i kompanisë: "EURO ABI"SH.P.K.

Numri fiskal: 600190722

Vend-Selia: Tiranës, -, VITI, Kosovë

Partneri 3.

Emri i kompanisë: Beni Construction SH.P.K.

Numri fiskal: 810063925

Vend-Selia: rr.Ismail Dumoshi, 10000, Prishtinë, Kosovë

Partneri 4.

Emri i kompanisë: Arifaj.shpk

Numri fiskal: J76418907K

Vend-Selia: Rr.Urani Pano, 1001, Tirana, Shqipëria

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 616-24-7202-5-1-1

Titulli i kontratës: 99 Ndërtimi i ishullit urban Arberi-Pallati i Rinisë

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 99 Ndërtimi i ishullit urban Arberi-Pallati i Rinisë

3. Çmimi total i tenderit është:

6,589,459.60 EUR

Dhe në fjalë *[shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]*

Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të

Nr.	Nën-kriteri	Koeficient	Përgjigje EO
1	Çmimi	0.60	6589459.6
2	Garancinë e punimeve min. 5 vite=0% Garancinë e punimeve max. 10 vite=20%	0.20	10
3	Plani dinamik max. 180 ditë = 0% Plani dinamik min. 120 ditë =20%	0.20	120

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 90 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender *[shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet]* si partner në konsorcium të udhëhequr nga *[shëno emrin e udhëheqësit]*. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke

tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj nesh nëse e bën këtë.

Informacion në lidhje me nënkontraktorët

Emri dhe adresa e nënkontraktorit	Numri fiskal - nënkontraktorë	Përshkrimi i pjesës së kontratës që do të nënkontraktohet	Pjesa vlera të nënkontraktohet	Përqindja e kontratës që do të nënkontraktohet (%)

"A" - Artikuj te pergjithshem

A. Artikuj te pergjithshem

Nr.	Ref. Spec. Tek	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Cnimi njesi (Euro) €	(Euro) €
(a)		(b)	(c)	(e)	(d)	(f=d*e)
A 1.1	3.1.1	Instalimet e perkohshme te kontraktorit duke perfshire punimin e rrethojës së kantierit me lartësi 2,0 m' me konstrukcion druri apo celiku dhe llamarinë të zingtuar apo panele druri.	m'	650.00	€ 40.00	€ 26,000.00
A 1.2	3.1.2	Punimi i objekteve të perkohshme të kantierit- zyrat e menaxhimit të kantierit, mbikëqyrësi si dhe hapësirat për punëtorë (garderobat, trapezeria dhe toaleti) me panele të parafabrikuara.	Paushall	1.00	€ 55,000.00	€ 55,000.00
A 1.3	3.7-3.8	Kosto e shërbimeve te perkoheshme (furnizim me rryme, uje etj.)	Muaj	18.00	€ 300.00	€ 5,400.00
A 1.7	2.2.4	Punimi i objekteve për deponimin e materialeve të ndryshme që do përdoren në kantier, të mbuluar dhe të mbyllura si dhe Testimi i cilësisë së materialeve (laboratori)	Paushall	1.00	€ 15,000.00	€ 15,000.00
A 1.8	3.4	Vendosja e pllakes se perthershme shenjezuese te nderteses	pcs	1.00	€ 3,500.00	€ 3,500.00
		Total		Total		€ 104,900.00
A		Rekapitulimi i artikujve te pergjithshem				€ 104,900.00
		Artikuj te pergjithshem		Total		€ 104,900.00

"B3" - Punet e dheut

B. Punet e dheut

Nr.	Ref. Spec. Tek	Pershkrimi	Niesia	Sasia	Cnimi njesi (Euro) €	(Euro) €
(a)		(b)	(c)	(e)	(d)	(f=d*e)
		Menjanimi i pengesave, pastrimi i terrenit si dhe germimi i gjere i dheut per themele pllake deri ne shtresen e tamponit t-60cm, ne thelesi sipas projektit.	m ³	11,520.00	€ 19.00	218,880.00
B.1.1	4.2.4	Germimi i terrenit: Ndertesja, parteri, parkingu, rruga brenda parceles dhe oborri				
B.1.3	4.2.5	Furnizimi, mbushja dhe ngjeshja e shtreses se zhavorit 10-15cm fraksion 0-31.5 mm. Moduli i ngjeshes duhet arrihet min. M=50 Mpa	m ³	2,972.28	€ 40.00	118,891.20
B.1.4	4.2.5	Furnizimi, mbushja e germimit me pjerrsi ne perimetrin e themeleve te brezit te jashtem	m ³	646.40	€ 10.00	6,464.00
B.1.5	4.2.6	Furnizimi, shtirja e membranese gjeotekstilit 500gr/m ²	m ²	6,905.99	€ 5.00	34,529.95
B.1.5	4.2.5	Rregullimi i terrenit pas perfundimit te ndertimit (nivelezimi i dheut te germuar dhe kthimi i tij ne pjeset tjera te parceles). Ne kete pozicion perfshihet ngjeshja e dheut te hedhur.	m ³	2,679.13	€ 10.00	26,791.30
		Total	Total			405,556.45
B		Rekapitulimi i puneve te dheut				405,556.45
		Punet e dheut		Total		405,556.45

PARALLOGARIA STRUKTURA

1 PUNËT E BETONIT		Njësia	Sasia	Qmimi njësi	Qmimi
1.1	Betonimi i shtresës rrafshuese të themeleve pllakë nga betoni i armuar me klasë C 16/20, me trashësi t=2x7cm. Klasa e ekspozimit X0.	m ³	997.9	€ 85.00	€ 84,821.50
1.2	Furnizimi me material, përgaditja e kallupeve, armimi si dhe betonimi i themeleve të objektit nga betoni i armuar me klasë të betonit C 30/37 Mpa (në cmim hyjné betonimi dhe punimi i kallupeve të themeleve të strukturës) Klasa e ekspozimit XC2; XD1; XM1.	m ³	4931.7	€ 115.00	€ 567,145.50
1.3	Furnizimi me material, përgaditja e kallupeve, armimi si dhe betonimi i shtyllave dhe mureve të objektit nga betoni i armuar me klasë të betonit C 30/37 Mpa (në cmim hyjné betonimi dhe punimi i kallupeve të shtyllave dhe mureve të strukturës) Klasa e ekspozimit XC1; XC4; XF1.	m ³	471	€ 115.00	€ 54,165.00
1.4	Furnizimi me material, përgaditja e kallupeve, armimi si dhe betonimi i shtyllave të parapërgatur nga betoni i armuar me klasë të betonit C 40/50 Mpa. Klasa e ekspozimit XC1; XC4; XF1.	m ³	255.5	€ 140.00	€ 35,770.00
1.5	Furnizimi me material, përgaditja e kallupeve, armimi si dhe betonimi i trajeve kryesore të parapërgatur nga betoni i armuar me klasë të betonit C 40/50 Mpa. Klasa e ekspozimit XC4; XF3.	m ³	173.25	€ 140.00	€ 24,255.00

1.6	Furnizimi me material, përgaditja e kallupeve, armimi si dhe betonimi i trajeve fertiore të parapërgatitur nga betoni i armuar me klasë të betonit C 40/50 Mpa. Klasa e ekspozimit XC4; XF3.	m ³	640.05	€ 140.00	€ 89,607.00
1.7	Furnizimi me material, përgaditja e kallupeve, armimi si dhe betonimi i pllakës dhe trajeve nga betoni i armuar me klasë të betonit C 30/37 Mpa (në cmim hyjné betonimi dhe punimi i kallupeve të pllakave të strukturës). Klasa e ekspozimit XC4; XF3..	m ³	2551.5	€ 115.00	€ 293,422.50
1.8	Furnizimi me material, përgaditja e kallupeve, armimi si dhe betonimi i pllakës mbi platformën e parapërgaditur nga betoni i armuar me klasë të betonit C 30/37 Mpa (në cmim hyjné betonimi dhe punimi i kallupeve të pllakave të strukturës). Klasa e ekspozimit XC4; XF3.	m ³	672.2	€ 115.00	€ 77,303.00

2	PUNËT E ARMATURËS				
2.1	Punimi i armaturës sipas të gjitha pozicioneve nga plani i detajeve të armimit, armatura e brinjëzuar B500C	kg	1,145,380.20	€ 1.40	€ 1,603,532.28
2.2	Punimi i armaturës së parandëruar për elementet e parafabrikuara sipas të gjitha pozicioneve nga plani i detajeve, armatura e parandëruar e kualitetit Y1860/1680, gjithashtu në qmim duhet parapërditje edhe tubat e plastikës për izolimin e armaturës së parandëruar në gjatësi të caktuara sipas detajeve në projektin kryesor (DYWIDAG 0.6" ose të ngjajshme)	kg	52,409.20	€ 2.50	€ 131,023.00

Qmimi Total	€ 2,961,044.78
--------------------	-----------------------

23-SHAK-07.1 - Mbikalimi Arbëri/Pallati I Rinisë

"D" - Arkitektura dhe ndërtimi

D1. Punet e themeleve

Nr.	Ref. Spec. Tek	D1. Punet e themeleve	Njesia	Sasia	Gmimi njesi (Euro) €	(Euro) €
(a)		(b)	(c)	(e)	(d)	(f=d*e)
D1.1	4.2.6	Furnizimi, shtrimi i membranës së gjeotekstilit 250 g/m ²	m ²	7,596.59	2.00	€ 15,193.18
D1.2	4.11.1.2	Furnizimi dhe punimi i hidroizolimit horizontal dhe vertikal i themeleve me aplikimin e bazës bitumi njeperberes, dhe folie me baze bitumene me polimere plastomer (APP), të perforcuara me fibra xhami nga të dyja anet	m ²	6,231.74	10.00	€ 62,317.42
D1.3	4.10.1.3	Furnizimi dhe punimi i termoizolimit të themeleve XPS (Extruded Polystyrene); ρ=50 kg/m ³ , EN 13163 me λ 0,040 - 0,032 W/mK 10 cm e trashë	m ²	3,468.18	12.00	€ 41,618.15
Total						€ 119,128.75

D2. Punet e Fasades

Nr.	Ref. Spec. Tek	D2. Punet e Fasades	Njesia	Sasia	Gmimi njesi (Euro) €	(Euro) €
(a)		(b)	(c)	(e)	(d)	(f=d*e)
D2.1	4.11.4	Furnizimi dhe instalimi i termoizolimit të fasadave me lesh guri me karakteristikë t=5cm, 7.5 dhe 16cm, Peshë=50kg/m ³ , rrezistenca ndaj zjarrit Class A1, konduktiviteti termik, λ =0,035 W/m*K, standardi EN 13162	m ²	1,039.75	10.00 €	€ 10,397.53
D2.7	4.12.3	Furnizimi dhe punimi i xkullës së ndertesës nga shtresat: baza e papërshkueshme nga uji, përfundimi përfundimtar me disa shtresa bojë plastike (RAL 9022), rrjetë tekstil me fije qelqi llaç ngjitur të përfshirë.	m ¹	499.99	10.00 €	€ 4,999.94
D2.8	4.11.16	Furnizimi dhe instalimi i elementeve/profileve termoizoluese nga XPS (Extruded Polystyrene) me dendësi 200kg/m ³ (në perimetër të dritareve nga ana e jashtme) për transferimin e peshës së dritareve. Elementet funksionin e eliminimit të urave termike. Instalimi bëhet sipas detajit të dhënë.	m ¹	901.23	5.00 €	€ 4,506.15
D2.9	4.10.1.3	Furnizimi dhe punimi i termoizolimit XPS (Extruded Polystyrene); ρ=50 kg/m ³ ; EN 13163 me λ 0,040 - 0,032 W/mK 2 cm e trashë) në perimetër të dritareve të fasadës sipas detajit të dhënë.	m ¹	385.22	5.00 €	€ 1,926.10
Total						€ 21,829.72

D3. Punet e kulmit

Nr.	Ref. Spec. Tek	D3. Punet e kulmit	Njesia	Sasia	Gmimi njesi (Euro) €	(Euro) €
(a)		(b)	(c)	(e)	(d)	(f=d*e)
D3.1	4.10.1.1	Furnizimi dhe aplikimi i bazës bitumi në parapetin e kulmit.	m ²	250.00	4.00 €	€ 999.99

D3.2	4.10.1.2	Furnizimi dhe instalimi i shtreses se kontrollit te avullit me baze polietileni (PE).	m ²	7,899.76	10.00 €	€ 78,997.60
D3.3	4.10.1.3	Furnizimi dhe punimi i termoizolimit XPS (Extruded Polystyrene) ; p=50 kg/m ³ ; EN 13163 me λ 0,040 - 0,032 W/mK 8cm dhe 10cm e trashe).	m ²	10,801.57	12.00 €	€ 129,618.85
D3.5	4.10.1.4	Shtresa e nivelizimit (per krijimin e 0,8% te pjerrtesise) ne kulmin e sheshte, trashesi 7-15 cm me pjerrtesi drejt grykave dhe uluqeve te kulmit, EN13813 Mix Design CT-C20-F4.	m ²	11,315.82	14.00 €	€ 158,421.49
D3.6	4.2.6	Furnizimi dhe instalimi i gjeotekstilit 300gr/m2 ne dy shtresa, njera shtrese nen shtresen e hidroizolimit (mbi shtresen nivelizuese) dhe shtresa tjetere mbi shtresen e hidroizolimit.	m ²	11,315.82	2.00 €	€ 22,631.64
D3.7	4.10.1.7	Furnizimi dhe instalimi i shtreses se hidroizolimit te kulmeve te rrafshita dhe parapetit te kulmit me folje TPO (1,5 mm i trashe), e mbivendosur te pakten 10-12 cm, e salduar, fiksuar dhe izolim mekanik ne perimetrin e çatise/nderfaqja me parapet.	m ²	10,247.66	25.00 €	€ 256,191.38
D3.10	4.10.1.6	Furnizimi dhe shtrimi i shtreses se zhavorrit te lumit me trashesi 5 cm mbi kulmin e rrafshite te perfunduar (mbi shtresen e gjeotekstilit).	m ²	4,790.26	10.00 €	€ 47,902.58
				Total		€ 694,763.53

D4. Punet e muratimit dhe mureve ndarese nga pllakat e gjipskartonit

Nr.	Ref. Spec. Tek	D4. Punet e muratimit dhe mureve ndarese nga pllakat e gjipskartonit	Njesia	Sasia	Cmimi njesi (Euro) €	(Euro) €
(a)		(b)	(c)	(e)	(d)	(f=d*e)
D4.1	4.4	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve te jashtme me betonit dhe gjeresi 250 mm.	m ³	804.14	65.00 €	€ 52,269.36
D4.2	4.4	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve te brendshme me bloqe te siporeksit, duke perdorur ngjitesin perkates te dedikuar per blloqe te siporeksit, me permasa standard te blloqeve (sipas prodhuesit) dhe gjeresi 250 mm. Ne kete pozicion duhet te parashihen edhe perforcimet horizontale dhe vertikale nga betoni i armuar me dimensione 25/20 cm, i perforcuar me 4 shufra Ø10 dhe traversa Ø8 ne cdo 15-20 cm.	m ³	84.06	85.00 €	€ 7,145.27
D4.3	4.5	Furnizimi i te gjitha materialeve te nevojshme dhe fuqise punetore per suvatimin e mureve me makine gipsi ne muret e brendshme, muret rrethuese te nderteses etj. - duke perfshire kendoret metalike, kryqezime, fuga levizese, kapak per kablote - nese nevojiten, rrjete me fije qelqi dhe te gjitha aksesoret e tjere per te perfunduar punimet e suvase. Ne cmim do te perfshihet shtresa e pershtatshme e bazes per muret AAC, beton dhe siperfaqe te tjera/te ndryshme	m ²	3,179.39	10.00 €	€ 31,793.85
D4.4	4.7	Furnizimi i materialit dhe mveshja ne njeran ane, e mureve ndarese, me plaka te gjipskartonit (W112/75 Hidro. + Normal + Hap. instal.) me shtresat: Plakë Gipsi - Hidroizoluese GKBI H13; Plakë Gipsi GKB A13; Termoizolim - Lesh Guri; Hapësirë ajrore; Termoizolim - Lesh Guri; Plakë Gipsi GKB A13; Plakë Gipsi - Hidroizoluese GKBI H13	m ²	33.55	20.00 €	€ 671.00

D4.4	4.7	Furnizimi i materialit dhe mveshja ne njeran ane, e mureve ndarese, me pllaka te gjipskartonit (W112/75 Hidroizoluese) me shtresat: Pllakë Gipsi - Hidroizoluese GKBI H13; Pllakë Gipsi GKB A13; Termoizolim - Lesh Guri; Pllakë Gipsi GKB A13; Pllakë Gipsi - Hidroizoluese GKBI H13	m ²	64.33	30.00 €	€ 1,929.84
D4.5	4.7	Furnizimi i materialit dhe mveshja ne njeran ane, e mureve ndarese, me pllaka te gjipskartonit (W112/75 Hidro. + Normal) me shtresat: Pllakë Gipsi GKB A13; Pllakë Gipsi GKB A13; Hapësirë ajrore; Termoizolim - Lesh Guri; Pllakë Gipsi GKB A13; Pllakë Gipsi - Hidroizoluese GKBI H13	m ²	279.97	20.00 €	€ 5,599.44
D4.5	4.7	Furnizimi i materialit dhe mveshja ne njeran ane, e mureve ndarese, me pllaka te gjipskartonit me shtresat: Pllakë Gipsi GKFI Diamant; Pllakë Gipsi GKF F13; Termoizolim - Lesh Gur	m ²	177.49	20.00 €	€ 3,549.70
Total						€ 102,958.46

D5. Punet e dyshemese dhe mveshjeve horizontale

Nr.	Ref. Spec. Tek	D5. Punet e dyshemese dhe mveshjeve horizontale	Njesia	Sasia	Gmimi njesi (Euro) €	(Euro) €
(a)		(b)	(c)	(e)	(d)	(f=d*e)
D5.1	4.10.1.2	Furnizimi dhe instalimi i foljes me baze poliuretani (PE) me trashesi 0,15 mm (1000 kg / m3), me mbivendosje 10 cm, ngjitur me shirit vetengjites 4 cm te gjere. Pergjate mureve shtrihen shirita polistireni 1 cm te trasha, lartesia e mbuleses perfundimtare te dyshemese.	m2	11,525.18	5.00 €	€ 57,625.92
D5.2	4.11.5	Furnizimi dhe shtrimi i izolimit t te dyshemese prej polisterenit te ekstraduar me trashesi nominale 6cm dhe 8cm, 150 kg/m3 (sipas EN 13164).	m ²	882.29	10.00 €	€ 8,822.88
D5.3	4.10.1.4	Furnizimi me material dhe punimi i shtrese nivelizuese nga betoni MB-30. Shtresa nivelizuese nga betoni perforcohet ne mes te lartesis me rrjete te salduar me diameter 5 mm, me boshte max. 10 x 10 cm. Rezistenca ne shtypje e veshjes duhet te jete min. 30 N / mm ² , forca ne perkulje 4 N / mm ² , fortesi (rezistenca ndaj depertimit) 60 N / mm ² .	m ²	3,879.26	10.00 €	€ 38,792.60
D5.4	4.11.2	Hidroizolim ne kthinat sanitare me membrane te lenghme hidroizoluese me baze gimento ne dy shtresa ne dysheme. Izolimi duhet te punohet duke duke perfshire pjeset percjellese sipas instruksioneve te prodhuesit si, rrjete ne kende, shirit vazhdues etj.	m ²	162.48	10.00 €	€ 1,624.79
D5.10	4.13.1	Furnizimi me material dhe instalimi i pllakave nga porcelani te cilëses se pare, mat, pa shkelqim në permasa nominale 120 x 60 cm dhe me ngjyre, model dhe karakteristika sipërfaqesore sipas perzgjedhjes duke përdorur ngjitës plakash	m ²	3,872.01	30.00 €	€ 116,160.33

D5.12	4.13.2	Furnizimi me material punimi i mveshjes se shkalleve dhe pushimoreve te jashtme pllake graniti natyral i flakeruar (flamed) me trashesi 3cm. Paraprakisht duhet te behet nivelizimi i shkalleve me shtrese nivelizuese nga betoni.	m ²	328.78	120.00 €	€ 39,453.48
D5.13	4.13.3	Furnizimi me material dhe punimi i dyshemese ne tualete nga materiali baze epoksidi dykomponentesh.	m ²	135.40	20.00 €	€ 2,707.98
D5.15	4.13.5	Furnizimi me material dhe punimi i parapeteteve te dritareve te ndertesese me pllake graniti me trashesi 3mm me nuanca hiri.	m ¹	358.71	35.00 €	€ 12,554.85
D5.16	4.15.2	Furnizimi me material dhe punimi i pikoreve te dritareve (nga ana e jashtme) te ndertesese nga alumini me trashesi t=2mm dhe nuanca RAL 9022.	m ¹	358.71	25.00 €	€ 8,967.75
D6. punet e mveshjes se mureve				Total	Total	€ 286,710.58

D6. punet e mveshjes se mureve

Nr.	Ref. Spec. Tek	D6. punet e mveshjes se mureve	Njesia	Sasia	Cmimi njesi (Euro) €	(Euro) €
(a)		(b)	(c)	(e)	(d)	(f=d*e)
D6.1	4.11.2	Furnizimi me material dhe hidroizolimi ne kthinat sanitare me membrane te lengshme hidroizoluese me baze çimento ne dy shtresa ne mure 30 cm lartesi, ne muret e lavamaneve dhe ne muret e guacave te WC ne toaletes izolimi duhet te aplikohet me lartesi 140 cm. Izolimi duhet te punohet duke duke perfshire pjeset percjellese sipas instrukcioneve te prodhuesit si, rrjete ne kende, shirit vazhdues etj.	m ²	216.64	10.00 €	€ 2,166.38
D6.2	4.6	Furnizimi me material dhe punimi i patinimit ne hapsirat e brendshme ne muret nga bloqet e Siporeksit dhe muret e Betonit (pas perfundimit te shtreses se ilaqit).	m ²	3,179.33	7.00 €	€ 22,255.31
D6.3	4.6	Furnizimi me material dhe punimi i patinimit ne hapsirat e brendshme ne muret nga pllakat e gjipskartonit.	m ²	1,110.67	5.00 €	€ 5,553.35
D6.6	4.9.1	Furnizimi me material dhe aplikimi i shtreses se baze dhe dy shtresave ngjyre baze uji gjysme mat me veqori antibakteriale ne siperfaqet e mureve te brendshme (muret nga bloqet Siporeks dhe muret nga pllakat e gjipskartonit)	m ²	4,290.00	4.00 €	€ 17,160.00
D7. Punet e tavaneve				Total	Total	€ 47,135.04

D7. Punet e tavaneve

Nr.	Ref. Spec. Tek	D7. Punet e tavaneve	Njesia	Sasia	Cmimi njesi (Euro) €	(Euro) €
(a)		(b)	(c)	(e)	(d)	(f=d*e)
D7.4	4.7-4.8	Furnizimi me material dhe ndertimi i tavaneve te varur me nenkonstrukcion metalik te dyfisht me sistem te varjes, duke perdorur pllaka gipsi rezistente ndaj ujit (pllakat e gipsit me nje shtrese 12,5 mm)	m ²	102.52	22.00 €	€ 2,255.44

D7.5	4.7-4.8	Furnizimi me material dhe ndertimi i tavanaeve te varur me nenkonstrukcion metalik te dyfisht me sistem te varjes, duke perdorur pllaka gipsi me veti akustike (pllakat e gipsit me nje shtrese 12,5 mm)	m ²	235.54	25.00 €	€ 5,888.50
D7.5	4.7-4.8	Furnizimi me material dhe ndertimi i tavanaeve të jashtme te varur me nenkonstrukcion metalik te dyfisht me sistem te varjes, duke perdorur pllaka gipsi të jashtme - Aquapanel (pllakat e gipsit me nje shtrese 12,5 mm)	m ²	1,680.54	30.00 €	€ 50,416.20
D7.8	4.9	Furnizimi me material dhe aplikimi i shtreses se bazes dhe dy shtresace ngjyre baze uji gjysme mat me vegori antibakteriale ne siperfaqet e tavanaeve nga pllakat e gipskartonit.	m ²	2,018.60	4.00 €	€ 8,074.40
				Total		€ 66,634.54

D8. Punet latuese

Nr.	Ref. Spec. Tek	D8. Punet latuese	Njesia	Sasia	Cmimi njesi (Euro) €	(Euro) €
(a)		(b)	(c)	(e)	(d)	(f=d*e)
D8.1	4.14.1	Furnizimi dhe instalimi i kabinave te WC me panele HPL t=18 mm duke perfshire te gjitha aksesoret e nevojshme	cope	16.00	450.00	€ 7,200.00
D8.2	4.14.2	Pos "De_01" 90x240 cm - Furnizimi dhe instalimi i dverve te jashtme nga alumini RAL 9022 me panic bar sipas skemes	pcs	4.00	700.00	€ 2,800.00
D8.3	4.14.2	Pos "De_02" 90x240 cm - Furnizimi dhe instalimi i dverve te jashtme nga alumini RAL 9022 me panic bar sipas skemes	pcs	2.00	700.00	€ 1,400.00
D8.4	4.14.2	Pos "De_03" 200x240 cm - Furnizimi dhe instalimi i dverve te jashtme nga çeliku RAL 9022	pcs	2.00	1400.00	€ 2,800.00
D8.5	4.14.2	Pos "De_04" 100x240 cm - Furnizimi dhe instalimi i dverve te jashtme nga alumini RAL 9022 sipas skemes	pcs	2.00	350.00	€ 700.00
D8.6	4.14.2	Pos "De_05" 600x225 cm - Furnizimi dhe instalimi i dverve te jashtme nga alumini RAL 9022 sipas skemes	pcs	4.00	5500.00	€ 22,000.00
D8.8	4.14.3	Pos "Di_01" 200x240 cm - Furnizimi dhe instalimi i dverve te brendshme me kornize alumini RAL 9022 dhe krahuj te dverve nga mediapani RAL 9022.	pcs	18.00	1300.00	€ 23,400.00
D8.9	4.14.3	Pos "Di_02" 80x210 cm - Furnizimi dhe instalimi i dverve te brendshme me kornize alumini RAL 9022 dhe krahuj te dverve nga mediapani RAL 9022.	pcs	2.00	300.00	€ 600.00
D8.10	4.14.3	Pos "Di_03" 90x210 cm - Furnizimi dhe instalimi i dverve te brendshme me kornize alumini RAL 9022 dhe krahuj te dverve nga mediapani RAL 9022.	pcs	4.00	300.00	€ 1,200.00
D8.11	4.14.3	Pos "Di_04" 100x210 cm - Furnizimi dhe instalimi i dverve te brendshme me kornize alumini RAL 9022 dhe krahuj te dverve nga mediapani RAL 9022.	pcs	2.00	350.00	€ 700.00
D8.13	4.14.3	Pos "Dm_01" 100x220 cm - Furnizimi dhe instalimi i dverve metalike me kornize alumini RAL 9022 dhe krahuj te dverve nga mediapani RAL 9022.	pcs	3.00	350.00	€ 1,050.00

D8.14	4.14.3	Pos "Dm_02" 200x220 cm - Furnizimi dhe instalimi i dyerve metalike me kornize alumini RAL 9022 dhe krahut i deres RAL 9022	pcs	1.00	1400.00	€ 1,400.00
D8.15	4.14.3	Pos "Dz_01" 100x240 cm - Furnizimi dhe instalimi i dyerve zjarrduruese me kornize alumini RAL 9022 dhe krahut i deres RAL 9022	pcs	5.00	400.00	€ 2,000.00
D8.16	4.14.3	Pos "Dz_02" 200x240 cm - Furnizimi dhe instalimi i dyerve zjarrduruese me kornize alumini RAL 9022 dhe krahut i deres RAL 9022	pcs	5.00	1400.00	€ 7,000.00
D8.17	4.14.4	Pos "W-01" 320 x 225 cm - Furnizimi dhe instalimi i dritareve nga korniza e aluminit me bariere termike dhe xham 33.1+16+4+16+33.1	pcs	2.00	2200.00	€ 4,400.00
D8.18	4.14.4	Pos "W-02" 400 x 225 cm - Furnizimi dhe instalimi i dritareve nga korniza e aluminit RAL 9022 me bariere termike dhe xham 33.1+16+4+16+33.1	pcs	4.00	4800.00	€ 19,200.00
D8.19	4.14.4	Pos "W_03" 200 x 240 cm - Furnizimi dhe instalimi i dritareve nga korniza e aluminit RAL 9022 me bariere termike dhe xham 33.1+16+4+16+33.1	pcs	3.00	1400.00	€ 4,200.00
D8.20	4.14.4	Pos "W_04" 300 x 250 cm - Furnizimi dhe instalimi i dritareve nga korniza e aluminit RAL 9022 me bariere termike dhe xham 33.1+16+4+16+33.1	pcs	3.00	2200.00	€ 6,600.00
D8.21	4.14.4	Pos "W_05" 600 x 250 cm - Furnizimi dhe instalimi i dritareve nga korniza e aluminit RAL 9022 me bariere termike dhe xham 33.1+16+4+16+33.1	pcs	15.00	5500.00	€ 82,500.00
D8.22	4.14.4	Pos "W_06" 400 x 250 cm - Furnizimi dhe instalimi i dritareve nga korniza e aluminit RAL 9022 me bariere termike dhe xham 33.1+16+4+16+33.1	pcs	24.00	4500.00	€ 108,000.00
D8.23	4.14.4	Pos "W_07" 100 x 300 cm - Furnizimi dhe instalimi i dritareve nga korniza e aluminit RAL 9022 me bariere termike dhe xham 33.1+16+4+16+33.1	pcs	8.00	400.00	€ 3,200.00
D8.24	4.14.4	Pos "W_08" 200 x 240 cm - Furnizimi dhe instalimi i dritareve nga korniza e aluminit RAL 9022 me bariere termike dhe xham 33.1+16+4+16+33.1	pcs	2.00	1400.00	€ 2,800.00
D8.25	4.14.4	Pos "W_09" 357 x 225 cm - Furnizimi dhe instalimi i dritareve nga korniza e aluminit RAL 9022 me bariere termike dhe xham 33.1+16+4+16+33.1	pcs	10.00	3500.00	€ 35,000.00
D8.26	4.14.4	Pos "Wi_01" 100 x 240 cm - Furnizimi dhe instalimi i fasades nga korniza e aluminit RAL 9022 dhe xham 33.1+16+4+16+33.1 se bashku me dyer paluese sipas skemes se dhene	pcs	3.00	400.00	€ 1,200.00
D8.27	4.14.4	Pos "Wi_02" 200 x 240 cm - Furnizimi dhe instalimi i fasades nga korniza e aluminit RAL 9022 dhe xham 33.1+16+4+16+33.1 se bashku me dyer paluese sipas skemes se dhene	pcs	26.00	1400.00	€ 36,400.00
D8.28	4.14.5	Pos "S_01" 812 x 200cm - Furnizimi dhe instalimi i fasades nga blloqet e qelqit "Glass Block" me dimensione 19x19cm. Në çmim përfshihet edhe llaçi ngjitës 1cm	m2	32.48	120.00	€ 3,897.60
					Total	€ 381,647.60

D9. Punet metalike

Nr.	Ref. Spec. Tek	D9. Punet metalike			Gjimi njesi (Euro) €	(Euro) €
(a)	(b)	Njesia	Sasia	(c)	(d)	(f=d*e)
D9.1	4.6.1	Punimi i gardhit te shkalleve te jashtme sipas skemes se dhene		m'	1,899.00	€ 246,870.00

		Total	€ 246,870.00
	Rekapitulimi i punëve të arkitektures dhe ndërtimit		
D1	Punët e themeleve		€ 119,128.75
D2	Punët e Fasades		€ 21,829.72
